



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 11.7.2013, në orën 13:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu – Kodra, Ismet Beqiri, Alma Lama, dhe Albert Kinolli.

Munguan: Xhavit Haliti, Fatmir Limaj, Vjosa Osmani, Blerim Shala dhe Suzan Novobërdali.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi: Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Amnistinë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi- Po fillojmë mbledhjen e jashtëzakonshme të Komisionit për Integritet Evropian, sipas vendimit të seancës plenare për anashkalimin e procedurave për Projektligjin për Amnistinë.

Kush është për këtë rend dite?

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, me pesë vota pro dhe një kundër, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Amnistinë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi- Njoftoi se Komisioni për Legjislacion nuk ka asnjë amendament të paraqitur për këtë projektligj. Po ashtu tha, paralelisht me Komisionin tonë, mbledhje janë duke mbajtur edhe Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për Komunitetet dhe Kthim. Sa i përket përputhshmërisë së projektligjit me legjislacionin e BE-së tha sipas arsyetimit të cilin ligji e jep në memorandum shpjegues dhe zyrës për Standardizim çështja e amnistisë i takon shteteve që të rregullojnë sipas interesit të shtetit. Andaj, rekomandoj që të votojmë rekomandimin lidhur me këtë projektligj.

Alma Lama- Tha nuk e kam marrë si të mirëqenë që shmangia e procedurave do të vlejë edhe për kohën e amendamentimit, pasi edhe nuk është sqaruar mirë. Për mendimin tim ky është një skandal shumë i madh çfarë po ndodh këtu në Kuvendin e Kosovës. Asnjë deputetit nuk po i krijohet mundësia që të bëjë amendamente. Unë personalisht tha i kam disa amendamente, pasi janë disa pika të neneve që duhet të fshihen, sepse ky projektligj përveç faktit që amnistion veprat të cilat janë kundër rendit kushtetues, amnistion edhe vepra të cilat janë kundër individit. Ky projektligj nuk është pjesë e *acquis* së BE-së, por është i lidhur drejtpërdrejt me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 13 që ka të bëjë me mjetet juridike. Në rast se ky projektligj kalon kështu si është, e shkel këtë nen. Konventa Evropiane është pjesë e Kushtetutës së Kosovës por edhe Kushtetuta e Kosovës ka nene të cilat flasin pikërisht për heqjen e mjetit juridik ndaj individit. Pra, në rast se shteti amnistion një krim që është bërë kundër një individi, atëherë këtij individi i lind e drejta që vetë ta marrë ligjin në dorë, sepse shteti nuk po ja garanton këtyre njerëzve atë çfarë duhet të sigurojë. Pra, të ndëshkoj personat të cilët kryejnë krime pikërisht nëpërmjet strukturave shtetërore. Mendoj që kjo shmangie e cila bëhet për arsye politike do të jetë shumë e dëmshme. Në rast se komisionet e tjera e paskan ditur se do të ketë një shmangie të tillë, unë dua t'i akuzoj ato pse nuk e kanë bërë publike, pse nuk janë njoftuar deputetët për një gjë të tillë. Një shmangie e tillë kur ligji miratohet tërësisht brenda një dite mund të ndodhë vetëm në situatë të gjendjes së jashtëzakonshme. Nuk po shoh asnjë lloj urgjence që ne si deputet të mos kemi mundësi gofë edhe vetëm një ditë, apo dy ditë që të bëjmë amendamente.

Blerta Deliu-Kodra- Sapo e përfundoi mbledhjen Komisioni për Legjislacion, pata rast të bisedoj me anëtarët e Komisionit. Është e vërtetë që është bërë një përshpejtim procedural, më informuan që nuk ka asnjë amendament për këtë projektligj. Ne do të kemi mundësi që edhe gjatë leximit të dytë t'i japim vërejtjet e tona, por meqë nuk cenon parimet e *acquis* së BE-së, pa e përmendur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut vota ime do të shkoj për.

Kryetari njoftoi se deputetët individualisht mund të paraqesin amendamente para seancës, në mënyrë që sekretaria është e obligueshme me ja shpërndarë të gjithë deputetëve vërejtjet dhe amendamentet para leximit të dytë. U njoftuam se një deputete ka bërë një amendament. Në parim pajtohem me shqetësimet, por procedura ne na ngarkon që projektligjin ta shqyrtojmë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, me pesë vota pro dhe një kundër, nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Amnistinë nuk rregullohet me Acqui të BE-së.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Lutfi HAZIRI